

Pershendetje,

Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion derguar me e-mailin me poshte, me lejoni tju bejme me dije si vijon:

- Lidhur me numrin e HEC-eve të miratuar për t'u ndërtuar në qarkun Dibër, bazuar në ligjin e koncesioneve, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka nënshkruar 37 kontrata koncesionare me shoqëritë koncesionare/subjekte për qëllime të veçanta për ndërtimin e HEC-eve në këtë qark si dhe 23 kontrata objekt i VKM-së Nr. 822, datë 07.10.2015 *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”*, e ndryshuar, ku MIE është palë në këto marrëveshje.
- Lidhur me statusin e këtyre kontratave, mund t'i drejtoheni drejtpërsëdrejti Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për të siguruar një informacion më të përditësuar lidhur me këto kontrata e cila në zbatim të Vendimit Nr. 547, datë 9.08.2006, të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”*, të ndryshuar, kryen edhe monitorimin e kontratave koncesionare dhe jo koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve.

Ndërsa referuar pikave 3, 4 dhe 5 të cilësuar nga ana juaj lidhur me konsultimet në publik dhe procedurat e ndjekura më pas, sqarojmë dhe theksojmë se:

- Legjislacioni përkatës në fushën e mjedisit, përcakton se zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, *“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”*, të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dokumentacionin e kërkuar në kuadër të pajisjes dhe vlerësimit të këtij projekti me VNM Paraprake, ku pjesë e procedurës së miratimit është edhe procesi i informimit dhe përfshirjes së publikut nëpërmjet konsultimit publik.
- Duke qenë se i gjithë procesi nga paraqitja e aplikimi deri në zbardhjen e lejes përkatëse të mjedisit, (në vijim VNM Paraprake/Thelluar sipas ndryshimeve të ligjit përkatës në fushën e mjedisit), është procedurë që ndiqet nga ministria përgjegjëse për mjedisin dhe strukturat në varësi të saj, sugjerojmë t'i drejtoheni drejtpërsëdrejti kësaj ministrie për vënien në dispozicion për sa kërkohet nga ana juaj.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin tuaj,